



PROCESVERBAL IV/2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së IV (katërt) për vitin 2025 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 18.04.2025
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Të pranishëm tjerë:

z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin fiskal 2024,të barten për shpenzim në vitin fiskal 2025;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve nga fondi rezerve në projekte kapitale për vitin 2025;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme;
6. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-mars 2025;
7. Njoftim i Mekenazimit kundër dhunës në familje;

Kryesuesi- Përsëritet të pranishmit dhe i njofton me rendin e ditës.dhe një pikë shtesë që sa po e solli Drejtori i Pronës,me sa po e shohë bëhet fjal për një parcelë në fshatin Bllacë,për më shumë informcaione na jep Drejtori.

Armend Krasniqi-Përsëritet të pranishmit.E kam marr nje shkrese nga Kryetari per me inicu nje procedur për dhënjen në shfrytëzim një pronës e cila gjendet në fshatin Bllacë zon kadastrale nga sipërfaqja 16257 m²,ndahen 6000 m² për dhënje në shfrytëzim me destinim është gurëthyes ,i keni të bashkangjitura edhe përshkrimin e drejtoris së Urbanizmit,licencen e shfrytëzimit,pëlqimin nga Komuna viti 2010 dhe pëlqim elektro energjetik të pales që e ka drejtu drejtë neve.

Kryesuesi-e hedh në votim të futet si pikë shtesë

4vota për,3 kundër futet si pike shtesë

Kryesuesi-e hedhë në votim rendin e ditës me një pikë shtesë

4 vota për,2 abstenime

Pika 1.Miratimi i procesverbalit

Kryesuesi-laboron pikën 1

Urim Suka-E lexova procesverbalin dhe në disa raste nuk arrita ta kuptoj qartë, madje as vetë nuk e kuptova plotësisht se çfarë kam dashur të them. Kjo nuk është një kritikë vetëm për këtë procesverbal të fundit, por si vërejtje praktike për të ardhmen. Meqenëse procesverbali është dokument zyrtar dhe mbetet si referencë, do të ishte mirë që kur të përpilohen, të pasqyrojnë më qartë thelbin e diskutimeve. Kuptoj që është e vështirë të përfshihen fjalë për fjalë të gjitha diskutimet, por do të ishte me rëndësi që të reflektohen qartë qëndrimet e shprehura nga anëtarët, në mënyrë që të mos humbet përmbajtja e tyre. Si sugjerim, nëse është e mundur, do të doja që në të ardhmen të pasqyrohen sa më qartë qëndrimet e secilit prej nesh.

Kryesuesi-e hedhë në votim

Miratohet

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;
Kryesuesi-laboron pikën
Kryesuesi-e hedhë në votim pikën 2

Unanimisht miratohet

Pika 3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin fiskal 2024,të barten për shpenzim në vitin fiskal 2025;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hapë debatin

Liridon Fondaj-Përshendet të pranishmit,deshta veq një sqarim a u dashtë aj vendim që e kemi marrë mu shfuqizu dhe me ardh tjetër vendim apo ban edhe kështu qysh ka ardhë.U deshtë me ardh si projektvendim sepse zakonisht ne e kemi shfuqizu ni vendim që e kemi marrë më heret.

Urim Suka-Përshendetje për të gjithë,për me u lidhë me këtë qka e tha Liridoni nga praktikat e më hershme është kan që na e kemi shfuqizu atë vendim që e kemi marrë por unë e kam lexu nenin që kjo është në rregull dhe neni 4 e parasheh që me hyrjen ne fuqi të nje vendimi shfuqizohet ai tjetri.Ajo që unë deshta me thanë tek ky vendimi për bartje,kohën e fundit menaxhimi i Komunës është duke u përball me 2 probleme kryesore të mëdha,problemi i par është pëtrmbaruesit që jan duke i marrë mjetet dhe ka ngecje,mos zhvillim të projekteve dhe problemi dytë është që edhe pse i keni pas mjetet nuk i keni shfrytëzu siq është kjo e bartjes që ne po duhet me i bart 701,000€ për me i kalu në vitin tjetër.Kjo lenë me kuptu që keni fillu pak me pasë probleme në menaxhim keni pasë gjithë por tash edhe më shume.

Kryesuesi-e hedhë në votim pikën 3

4 Për ,1 Kundër,2 Abstenime miratohet

Pika 4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve nga fondi rezerve në projekte kapitale për vitin 2025;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hapë debatin

Urim Suka-Veq edhe diqka po du me dit profesionalisht se nuk po mundem me kuptu ,pse Komuna nuk ka drejtë me nda fond që i qetë drejtpërdrejtë në emer të Eko-Therandës,a nuk mundem ne mi parapa do mjete që shkojnë drejtpërdrejtë për atë ndërmarrje.

Avni Bytyqi- Eko-Theranda është ndërmarrje publike 100% në aksione të Komunës dhe është në funksionalizim e sipër,ne për me subvencionua Eko-Therandën duhet me planifiku buxhet prej kategorisë së subvencioneve deri sa ajo fillon me funksionalizu vetë dhe krijon të hyra vetanake,dhe ne si Komunë i kemi planifikua disa shërbime që në të ardhmen kemi me ja bartë prej kompetencave të Komunës në kompetencë të Eko-Therandës dhe Eko-Theranda po të funksionalizohet me staf profesional e ka të drejtën të udhëheq edhe procedura të prokurimit,ka të drejtë të krijoj edhe shpenzime financiare sipas ligjit.Por për momentin nuk kemi buxhet të planifikum për me i nda drejtëpërdrejtë në Eko-Therandën.

Liridon Fondaj-Qeky fond a mundet me u shfrytëzu edhe për diqka tjetër?

Avni Bytyqi-Po

Kryesuesi- e hedhë në votim pikën 4

4Për,1Kundër,1 Abstenim miratohet

Pika 5.Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hapë debatin.

Urim Suka- Me qenëse kem Drejtorin ktu unë deshta me e ditë disa informata nga Drejtori, e para me kërkesën që ka ardhë ju po thoni që vazhdimisht qytetet kërkojnë me marrë prona atje,dhe ju po doni me dhanë pëlqimin për 34 prona,A jan krejtë pronat që i ka Agro-Zona këtu që je tu deshtë me i hap?A është kërkes për krejt këto 34 prona apo nuk është?A është i njëjti person që po don me i marrë?

Armend Krasniqi-Iniciativa për marrjen e dhënjes në shfrytëzim të të gjitha pronave në Agro-Zonë të cilat gjenden në Zonë Kadastrale në Samadrexhë është faktikisht si Zonë e dështuar në mënyrë që me i nxitë qytetaret për të investuar dhe për të zhvilluar aktivitete bujqësore të cilat janë të parapara me harta zonale dhe me plan specifikku është miratuar nga drejtoritë e kaluara.Unë kam marrë iniciativë që këto prona ti inicojë dhe ti japë në shfrytëzim për dhënje afatgjate për shkak se nuk po zhvillohet asnjë aktivitet.Kriterët mundet me i vendosë Komisioni.

Urim Suka- Sa i përket zhvillimt të Zonës,unë me sa kam informacionë Zona për të cilën po flasim që ti po don me e dhën në shfrytëzim,si Komunë i obligohesh me e ba infrastrukturën e nevojshme,qoftë rrugore,rrymë ujë,kanalizim me sa e di unë secila nga këto mungojnë.Në kuadër të kësaj që ti e ke hap pëlqimin unë mendojë në kuader të strategjisë së Komunës për me e zhvillu atë Zonë duhet me fillu me rregullimin e infrastrukturës për me e ba funksionale.

Liridon Fondaj-Drejtorë ti the në kuadër të propagandës ose promovimit si do që të jetë,ti ki kërkesa në Drejtori që kan bër qytetarët edhe më heret për këto Zona dhe Zona tjera që janë pjesë të Komunës dhe asniher nuk i ke sjellë,kjo po i bie që është vit zgjedhorë dhe ne duhet me e ba këtë taman si propagandë që e the,të paktën me pasë një kërkesë prej dikujt që janë të interesur për këto veprimtari.

Armend Krasniqi-Deri më tani kam pranuar deri në 25000 kërkesa në Drejtorin time dhe asnjë kërkesë nuk ka mbetur pa përgjigje.Sa i përket infrastrukturës aty ka kanalizim,ujë rrym dmth aty mungon vetëm asfalti dhe deri në Shtator mundemi me finalizu.

Liridon Fondaj-Përpunimi i Mishit dhe therrrtorja,cila parcelë qaty i plotëson këto kushte pët me zhvillu këtë veprimtari?

Armend Krasniqi-Kjo Agro-Zonë kur i ka kalu fazat për me planifiku mirë zonën ka pas dëxhime publike në të cilat kam marrë pjesë dhe unë dhe ka pasë të gjitha rrugët ligjore për me e bo një Zonë qysh e ka planifiku mirë Komuna e Suharekës.

Kryesuesi- e hedhë në votim pikën 5

6 Për,1Abstenim miratohet

Pika 6.Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-mars 2025;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hap debatin

Urim Suka-unë sapo e mora materialin dhe u mundova me lexu ,fokusi kryesor i asaj ishte tek shpenzimet kapitale që këtu po figuron që te lista e projekteve kapitale dikun 655,666€ janë shpenzu dhe në projekte të caktume po figuron që ku janë shpenzu kto mjete dhe unë kur e llogarita dikun 12% e shpenzimit dhe mu dok që Komuna paska fillu me ndryshu qasjen prej më herët se zakonisht e ka pas 1% shpenzimin 3 mujorin e par dhe është e mudëshme me pas shpenzime të ulëta te investimet kapitale sepse investimet kapitale zhvillohen mbas muajit 3.Kur fillova me analizu qka ka ndodhë ndërtimi i pullazit në Stadiumin e Qytetit në Suharekë jan shpenzu 195,000€ unë para dy dite kam qenë aty nuk ka fillu kurgjo,ndërtimi i Shkollës në Njëpërbishtë un kam qen në vizitë as aty nuk ka fillu kurgjo,50,000€tek ndërtimi i Zonav infrastrukturore smart por kur dal në qytet nuk ka ndodhë kërkun ky investim.Dhe në fund e kuptova që këto shpenzime jan për shkak të përmbaruesit jo që ju i keni shpënz,gati po del që ju vetem 30,000€ në QKMF.dhe kërkun deri tash ju spaskeni fillu me bo si Komunë,investimet kapitale për

3 mujorin e parë jan 0%.Ajo që unë deshta kur e lexova pse në fillim nuk ke një sqarim te pasqyrat përfundimtare që qeky shpenzim të investimet kapitale kaq mjete ka marrë përmbaruesi që mos me pasë nevojë ne me bo analizë.Unë ndjejë keqëardhje për këtë mënyrë të shpenzimit të buxhetit,ndjejë keqardhje për ato probleme që i keni si Komunë dhe projektet që i kan me përmbarues sepse e dimë që projektet mbesin keqë.I kam edhe dy shqetësime tjera që po du me i ditë pak a shumë tek këto shpenzimet e Zyrës së Kryetarit ,telefonja mobile 1236€ për 3 muaj po më duken shume nëse mundesh mem sqaru.Furnizim për ushim dhe pije jo dreka zrtare 2390€ edhe kjo mu dok e ekzagjerume si shifër deshta me e ditë për qfar ushqimi jan shpenzu gjithë këto mjete,Kompenzim i përfaqësimit brenda vendit 3400€ veq po du me ditë ku kan shku këto dhe transfer për përfitues individual 8000€ munden me kan subvencione.

Labinot Halitjaha -tek puna e përmbaruesit që u diskutua kjo është qështje që smundet me u fshehë,dhe ne kur e bejmë raportin i kemi të ndara kategorit ku duhet me thën që kan dal prej kësaj kategorie.për pjesën tjetër që the nuk keni investu kurgjo ,ne jemi muajtë e parë të vitit procedurat kan fillu në disa projekte dhe besojë që fundi vitit është larg qysh e kemi shpenzu viteve të kalume kemi me shpenzu edhe këtë vit.Janë borxhet edhe vitit të kalum që kan mbetë duk u pagu këtë vit.Telefonia është e të gjithve.

Avni Bytyqi- jo dreka zyrtare nënkuptojnë pijet e byfesë që furnizohen të gjithë Kryetari, Kryesuesi ,Drejtorët dhe zyrtarët që kanë të drejtë.

Liridon Fondaj-atë që e tha Urimi tek projektet kapitale ne po i kalojmë qështu por është dashtë një njoftim i administrimit buxhetit si Asambleistë një arsyetim se ne rea.lishtë kështu si jan po besojmë që jan kry se në letër thotë qëjan kry realishtë ne me dokumente duhet me fol e jo qysh. Dim ne.

Kryesuesi- e hedhë në votim

4 Për,3 Abstenime miratohet

Pika 7.Njoftim i Mekanizmit kundër dhunës në familje;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hap debatin.

Bulëza Kuçi-A keni parapa rekomandime për vitin e ardhshme?

Habibe Bytyqi-Nuk planifikohen rekomandimet për vitin paraprak, por ato dalin gjithmonë prej takimeve që mbahen.

Avni Bytyqi- pjesë e këtij mekanizmi jam edhe unë,ky mekanizëm ka tregu rezultat në qështjen e ndikimit te Policia për arsye që ata kan pas nevojë dhe kërkesë që tu ndihmohen me mjete financiare përshkak që viktimat kur të shkojnë kan pasojat nga 48h me fëmij,nuk kan ushqim,dhe Komuna ka shprehë gadishmërin me i ndihmu Policien që atyre viktimave me ju ofru shërbime(ushqim,pije),dhe shumë pjesë tjera ky mekanizëm i ka rekomandu Kryetarit dhe që Kuvendi ka marrë vendim,strehimorën në Prizren e ka financu me 4000€,keto jan rekomandime që i ka zbatu Komuna.

Urim Suka-dhuna në familje është një dukuri serioze dhe që ne duhet me marrë me seriozitetin më të madhë dhe krejt qka ka mundesi dhe kompetencë Komuna duhet me ndërvepru që me e siguru trajtimin e duhur dhe me qëllim të parandalimit si dukuri.

Ajo që unë deshta me marrë informata ,sa i përket qëllimit të menaxhimit të rasteve me probleme të shëndetit mendor,dmth është fjala kur një person ka problem me shëndetin mendor,ky personi është dorzu ndaj dikujt apo ata ndaj këtij personi 195 raste jan paraqit,qka mundemi me rekomandu ,si trajtohen dhe kush e ka kompetenc më shume,edhe nëse si Kuvend mundemi me ba diqka më shumë, ne jemi të interesuar qe me ju ndihmu për me parandalu këtë dukuri që po i dëmton familjet.

Habibe Bytyqi-i trajton shëndeti mendor,ndërsa për terapin ampullare kujdeset QKMF.

Sanije Kuçi Rexhepaj- pasi që edhe unë jam pjesë e mekanizmit ,tek pjesa e rasteve përsëritëse nga ana e QKMF-së që ne kemi ndëgju shqetësime në mbledhjen e mekanizmit është se kta po arrestohen dhe kta jna me te meta mendore por terapia a u jepet në atë fazë sa jan të arrestuar është pak shqetësuese dhe diskutabile, në momentin që ata po lirohen dhe po e kryen atë denimin që e kan marrë nga gjykata ata po dalin ndoshta edhe më agresiv se sa që kan hy.Kjo është njëra nga shqetësimet qe ne si mekanizëm jem tu e disku vashdimisht se qysh me i trajtu sa jan mbrenda qelisë.

Dardan Berisha-Ne si KPF po edhe si Asambleistë qka mundemi me ju ndihmu juve si mekanizëm në këtë drejtim,a mundemi me nda ndonjë buxhetë të veçantë për trajtimin e këtyre dukurive?

Nënkryetarja-Urgjente është ky fondi i emergjencës qe e kemi dergu na dhe e ka përkrah fuqishëm Kryetari.Deri në 99€ i blejn ata vetë QPS-ja për rastet që i kan,pikërisht për rastin e këtyre dy bashkshortëve i furnizojnë me ushqim .Mundesit tjetër nuk ka me nda buxhet për mekanizëm por prej subvencioneve.

Kryesuesi-e hedhëm por prej subvencioneve.

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Kryesuesi-e hedhë në votim pikën shtesë

4 Për,3 kundër miratohet pika shtesë

Takimi përfundoi:14:14